

Rezoluta

E drejta për akses në informacion dhe llogaridhënia për shërbimet publike

Konferenca e 10-të Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit,

Me besimin në një shoqëri të hapur e cila forcon të drejtën e publikut për informim nëpërmjet mekanizmave të duhur të transparencës dhe favorizon pjesëmarrjen dhe angazhimin e qytetarëve;

Duke marrë në konsideratë se dhënia me koncesion e shërbimeve publike për kompanitë e sektorit privat dhe organizatat e tjera jo-publike është zhvilluar në mënyrë të konsiderueshme gjatë 25 viteve të fundit, nga format më të thjeshta të koncesioneve të cilat ofrojnë mallra ose shërbime deri te marrëveshjet koncesionare inovative në fushat më të ndjeshme të shërbimit publik të cilat më parë konsideroheshin si funksione thelbësore të qeverisjes, për shembull, në fushat e kujdesit për të moshuarit, të kujdesit shëndetësor, burgjeve, shërbimeve publike dhe infrastrukturës;

Duke ditur se modelet e ofrimit të shërbimeve kanë ndryshuar me kalimin e kohës dhe në këtë mënyrë mund të ndikojnë të drejtën e publikut për të ditur se si organizatat jo-publike ofrojnë shërbime publike dhe përdorin fonde publike;

Duke marrë në konsideratë sfidën e shqyrtimit të shpenzimeve publike dhe asaj të ofrimit të shërbimeve nga konkensionarët;

Duke marrë në konsideratë ndikimin në vlerat e rëndësishme demokratike si përgjegjshmëria dhe transparenca dhe ndjekjen e interesit publik;

Duke marrë në konsideratë larminë e planeve kombëtare të veprimit të qeverive në kuadër të nismës së Partneritetit për Qeverisjen e Hapur/Open Government Partnership, e cila thekson reformat e dobishme të ndërmarra nga shumë shtete gjatë viteve të fundit, veçanërisht në lidhje me kontraktimin e hapur¹;

Të bindur se masat e transparencës proaktive nëpërmjet standardeve të hapura kontraktuese mund të ndihmojnë për të siguruar llogaridhënien e duhur për fondet publike;

Të ndërgjegjshëm për rëndësinë e transparencës në procesin e prokurimit për të parandaluar korrupsionin;

Duke marrë në konsideratë se në disa juridiksione janë miratuar ligje, që shtrijnë aksesin në informacionin e mbajtur nga organizatat jo-publike;

Duke kujtuar, gjetjet e Komisionerëve të Informimit për sfidat e kësaj çështjeje në sondazhin e Konferencës së vitit 2017 dhe në raportin e Centre of Freedom of Information ‘Në përvojën e

¹ http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/OGP_NAP-Report_Dec2016.pdf

Komisionerëve të Informimit: Rezultatet e Anketave të Rrjetit Ndërkombëtar të Komisionerëve të Informimit, 2013’.

Konferenca vendos që:

- Aty ku është e përshtatshme me rregullat kombëtare përkatëse, të inkurajohen iniciativat dhe programet për të përmirësuar legjislacionin për të drejtën e informimit në lidhje me shërbimet e dhëna me konçesion dhe shërbimet e ofruara nga organizatat jo-publike;
- Të nxiten iniciativat globale që ofrojnë standarde për kontraktimin e hapur²;
- Të krijohet një grupi pune i Konferencës për të shkëmbyer praktikat në lidhje me iniciativat që kërkojnë përmirësimin e të drejtës për informim në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike nga organizatat jo-publike, duke raportuar më pas në konferencën e 11-të në vitin 2019.

² Shikoni “Open Contracting Partnership” – Parimet Globale